



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .04.2023

**Lënda:** Përgjigje kërkesës së paraqitur nga MCN Tv  
Adresa: Rruga e Vilave Lundër **Tiranë**  
E-mail : \_\_\_\_\_@gmail.com

Të nderuar,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, nr. 677 prot datë 05.04.2023 (tonën) dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) me anë të së cilës në referencë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkohet vënia në dispozicion e dosjeve për 4 (katër) shtetas shqiptar, konkretisht:

1. Z. L.B.
2. Z. F.C.
3. Z. F.L.
4. Z. P.M.- ju informojmë se :

Së pari baza ligjore në kërkesën tuaj për informacion, është vendosur bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.

Por nga shqyrtimi i objektit të kërkesës si media, vërehet se kërkesa juaj për informacion i nënshtrohet dhe rregullohet nga dispozitat procedurale të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, për mënyrën se si të aksesohet informacioni, sipas dispozitave njohëse dhe kufizuese të ligjit nr. 45/2015.

Sa më sipër ligji nr. 45/2015 i ndryshuar, parashikon në nenin 38 “**Informimi i medias**” të drejtën e përfaqësuesve të medias për të konsultuar të dhënat e Sigurimit ku përcaktohet:

*“1. Vënia në dispozicion dhe përdorimi i dokumenteve nga media kryhet në përputhje me nenet 36 dhe 37 të këtij ligji.*

*2. Kur publikimi i të dhënave personale, të siguruara sipas këtij ligji, shoqërohet me deklaratat kundërta të personave të përmendur, këto deklaratat u bashkëlidhen të dhënave personale dhe ruhen, vihen në dispozicion e lejohet të publikohen, në të ardhmen, vetëm së bashku me deklaratat kundërshtuese”.*

Bazuar në dispozitën e mësipërme të ligjit nr. 45/2015 lidhur me procedurën për shqyrtimin e dokumenteve, vënien në dispozicion dhe përdorimin e dokumenteve nga media, nevojitet të plotësoni formularin përkatës për studiues, media i miratuar nga Autoriteti me qëllim adresimin e kërkesës tuaj, në dispozitën e përcaktuar nga ligji e më pas vijimin e trajtimit të kërkesës. Kjo qasje do të garantohet në kushte që sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe privatësinë e individëve të përmendur në dosje. Bashkëlidhur gjeni formularin dhe Udhëzuesin për studiues/media të miratuara nga Autoriteti.

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit**

**L. Cocoli**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Suela Prençi**